

4 vjetori
anniversary
godisnjica

Asociacioni i Komunave të Kosovës
Association of Kosovo Municipalities
Asocijacija Kosovskih Opština

30 qershor 2005, katër vite të AKK-së

Për të realizuar sa më mirë dhe sa më me efikasitet objektivat e pushtetit lokal në Kosovë, katërvjetori i punës dhe aktiviteteve të Asociacionit të Komunave të Kosovës tregon se sa shumë është bërë e sa shumë ka mbetur për t'u arritur në të ardhmen. Urime e Suksesese!!!



Asociacioni i Komunave të Kosovës
Association of Kosovo Municipalities
Asocijacija Kosovskih Opština

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

Buletini

Viti II,

Nr. 10

Maj & Qershor 2005

Intervistë e z.Smet Beqirit - u.d i kryetarit të Asociacionit të Komunave të Kosovës

Komunat e Kosovës kanë përmbushur shumicën e objektivave të projektuar pesë vite më parë

Meqë numri i 10 i Buletinit të Asociacionit të Komunave të Kosovës publikohet me 30 qershor, në katër vjetorin e punës dhe aktiviteteve të AKK-së, zhvilluam një bisedë të shkurtër me z.Smet Beqiri u.d i kryetarit të AKK-së.

Ku është sot pushteti lokal i Kosovës dhe vetë AKK-ja si përfaqësues i interesave të komunave të Kosovës?

Pushteti lokal i Kosovës më saktësisht Kuvendet Komunale të Kosovës janë aty ku përafërsisht e kanë projektuar pesë vite më herët, kur janë mbajtur për herë të parë zgjedhjet lokale në Kosovë. Secilin vit, prioritetet e Kuvendeve Komunale po

pësojnë ndryshime, e kemi filluar punën me evidentimin e dëmeve dhe pasojave të luftës, kemi vazhduar me rindërtim e tani po punojmë në zhvillimin ekonomik lokal, gjithnjë duke qenë pjesë e të arriturave kombëtare të Kosovës. Në këtë drejtim rol të madh dhe të pamohueshëm ka luajtur dhe vazhdon të luaj Asociacioni i Komunave të Kosovës i cili si përfaqësues i interesave të komunave ka arritur rezultatet të lakmuëshme si në aspektin e brendshëm ashtu edhe atë të jashtëm. Padyshim se ky sukses i atribuohet kryetarëve e kryeshëfave ekzekutiv të komunave, udhëheqjes së kaluar të AKK-së dhe Organizatës ndërkombëtare IFES Ltd e AER-it si dhe këshilltarëve të ndryshëm ndërkombëtar e vendor, ku të gjithë meritojnë lëvdatat dhe falënderimet tona në këtë përvjetor të AKK-së.



Ismet Beqiri

Cili është mendimi Juaj si udhëheqës i Asociacionit të Komunave të Kosovës në lidhje me Reformimin e Pushtetit Lokal në Kosovë?

AKK-ja dhe unë personalisht e përkrahim Reformimin e pushtetit lokal në Kosovë, sepse është proces, që krahas se duhet të sjell të mira pushtetit lokal, pra të bëhet reformimi me qëllim të mirë është proces që e kanë kaluar ose duhet ta kalojnë të gjitha pushtetet e Evropës Juglindore si rrugë për të hyrë në familjen e madhe evropiane që është edhe njëri ndër synimet tona nacionale.

Ditë më parë AKK-ja ka nënshkruar një Memorandum të Mirëkuptimit me Ministrinë e Pushtetit Lokal. Çka do të thotë kjo për Asociacionin?

Ky memorandum është përgatitur me qëllim të qartësishtimit të parimeve të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve mes Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Me këtë Memorandum specifikohet që AKK-ja është përfaqësues i komunave i bazuar në pjesëmarrjen vullnetare dhe interesin e përbashkët. Rëndësia e madhe e këtij memorandumit të nënshkruar konsiston në dy segmente. E para, në atë të afrimit të pushtetit lokal të Kosovës me Këshillin e Evropës (ku AKK-ja ka statusin e vëzhguesit) meqë këto dy institucione zotohen në promovimin e Kartës Evropiane të Këshillit të Evropës për Vetëqeverisje Lokale si dhe për forcimin e qeverive të zgjedhura lokale si një nga parimet bazë të vetëqeverisjes lokale në mbarë Evropën. E dyta, me këtë memorandum të mirëkuptimit, veprimet në kuadër të Partneritetit të krijuar nëpërmjet këtyre dy institucioneve do të udhëhiqen nga parimet si, nevoja për të zhvilluar vetëqeverisjen

lokale demokratike, forcuar kapacitetin e komunave për t'u marrë në mënyrë të parvarur dhe pa ndërhyrje të panevojshme me çështjet lokale, nevoja për të përkrahur bashkëpunimin mes komunave dhe bashkëpunimin mes nivelit lokal dhe qendror.

Cili është mesazhi Juaj në këtë përvjetor të AKK-së?

Gjithnjë duhet të ofrojmë shërbime më të mira dhe nuk guxojmë të jemi të kënaqur me atë që është arritur. Pra, rruga e nisur e udhëheqjeve komunale të legjitimuara me votën e qytetarëve duhet vazhduar edhe më tej. Kjo rrugë përfshin që nga ofrimi i shërbimeve të përditshme për qytetarët, krijimin e infrastrukturës për një jetë sa më të lehtë e deri tek ngritja dhe forcimi i institucioneve komunale.

Bisedoi: Arsim Osmani

Në këtë numër

Udhëheqësitë e Komunave dhe Ministri i Pushtetit Lokal diskutuan mbi "Reformat në Vetëqeverisjen Lokale - Programi i Punës për 2005"

Kolegjiumi i Kryeshëfave Ekzekutiv i shkruan letër kryeministrit z.Bajram Kosumi

U prezantua Draft-Plani Strategjik për koordinatoret komunal për të Drejtat e Fëmijëve

Aktivitete të AKK-së

NË NJË TAKIM TË ORGANIZUAR NGA ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

Udhëheqësitë e Komunave dhe Ministri i Pushtetit Lokal diskutuan mbi "Reformat në Vetëqeverisjen Lokale - Programi i Punës për 2005"

Asociacioni i Komunave të Kosovës ka organizuar një takim me kryetarë dhe kryeshefa ekzekutiv të komunave të Kosovës ku kanë diskutuar në temën "Reformat në Vetëqeverisjen Lokale - Programi i Punës për 2005" ku udhëheqësve komunale iu prezantua korniza e dokumentit "Reforma e vetëqeverisjes lokale". Në këtë takim mori pjesë edhe ministri i Ministrisë së Pushtetit Lokal, z. Lutfi Haziri i cili bëri prezantimin e dokumentit mbi reformat administrative, dokument ky i aprovuar edhe nga Qeveria e Kosovës.

Takimin e ka hapur dhe e ka kryesuar u.d. i kryetarit të AKK-së z. Ismet Beqiri i cili tha se projekti i reformimit të pushtetit lokal në Kosovë është në krye të agjendave të institucioneve lokale dhe qendrore. Është ky një proces që duhet të ballafaqohemi më të sado i vështirë të jetë dhe sado i kushtueshëm që do të jetë sepse është proces që do të shkojë në favor të forcimit të ofrimit të shërbimeve nga ana e pushtetit lokal për qytetarët e komunave. Duke marrë fjalën në këtë takim, ministri i Ministrisë së Pushtetit Lokal z. Lutfi Haziri tha se dokumenti mbi reformimin e pushtetit lokal në Kosovës është dokument i nxjerrë vitin e kaluar dhe i adaptuar këtë vit dhe që tashmë ka edhe konsensusin në Parlamentin e Kosovës. Pas diskutimeve në parlament kemi inkuorparuar rekomandimet e deputetëve që tashmë është dokument dhe projekt edhe



më i kompletuar dhe tashmë do të punojmë në përgatitjen e infrastrukturës ligjore si pjesë e reformimit të pushtetit lokal në Kosovë. Kështu Draft Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale do të dërgohet për diskutim nëpër komuna në mënyrë që të kemi një ligj sa më të mirë e të zbatueshëm. Më pas ministri Haziri ka detajizuar shumë pjesë të dokumentit mbi Reformën në Vetëqeverisjen Lokale si dhe ka elaboruar përmbajtjen e tërë dokumentit. Po ashtu ministri Haziri ka përmendur edhe nënshkrimin e Marrëveshjes së Mirëkuptimit mes MPL-së e AKK-së, ku tha se AKK-ja do të jetë pjesë përbërëse në punën në lidhje me politikat lokale në Kosovë. Kryetari i komunës së Kamenicës z. Shaip Surdullli tha se ne nuk kemi pasur mundësi ta analizojmë këtë dokument sepse ai na ka arritur sot mirëpo megjithëkëtë ne si kryetar të komunave do të japim sugjerimet tona. Shpresojmë se ky është fillimi i debateve të tilla për temën shumë të rëndësishme, reformimi i

Delegacioni i AKK-së mori pjesë në Kongresin e Autoriteteve Lokale të Këshillit të Evropës në Strasburg

Delegacioni i Asociacionit të Komunave të Kosovës z. Ismet Beqiri u.d. kryetarit të AKK-së z. Ismet Beqiri, nënkryetari i AKK-së z. Ramadan Gashi dhe kryetari i komunës së Novobërdës z. Petar Vasiqi morën pjesë në mbledhjen plenare në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Regionale të Këshillit të Evropës, që u mbajt në Strasburg. Ushtruesi i detyrës së kryetarit të Asociacionit të Komunave të Kosovës z. Ismet Beqiri duke folur në emër të komunave të Kosovës shprehu mbështetje të plotë reformimit të pushtetit lokal në Kosovë. Ai po ashtu paraqiti përkrahjen e fuqishme që i jepet institucioneve të Kosovës, Presidentit, Qeverisë e posaçërisht Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në Kosovë si dhe bashkëpunimit të ndërsjellë të nivelit lokal me atë qendror.

pushtetit lokal në Kosovë. Kryetari i komunës së Vushtrrisë z. Muharrem Shabani tha se kjo është formë e mirë e debateve për reformimin e pushtetit lokal kurse qasja e institucioneve duhet të jetë transparente dhe serioze në lidhje me aktivitetin dhe punën në këtë drejtim. Është imperativ i kohës nxjerrja e Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale e i cili duhet të ofroj më shumë fuqi vendimmarrëse të komunave.

Kryeshefi ekzekutiv i komunës së Prishtinës z. Sami Hamiti tha se mendoj se kjo çështje po diskutohet pakëz vonë. Në bazë të këtij dokumenti shihet se po krijohen komuna me 5000 banorë kurse e dimë se 30 komuna janë pak për Kosovën dhe ofrimin e shërbimeve komunale.

Kryeshefi ekzekutiv i komunës së Prizrenit z. Ragip Gajraku tha se MPL-ka ka bërë mjaft mirë që i ka paraprirë nxjerrjes së ligjeve për nivelin lokal. Ky dokument mbi reformimin e pushtetit lokal i eliminon opinionin e krijuar në Kosovë se me reformim të pushtetit lokal do të bëhet riorganizimi territorial i Kosovës.

Kryetari i Komunës së Ferizajit z. Faik Grainca tha se nxjerrja e ligjit mbi vetëqeverisjen lokale është shumë e nevojshëm, ndërsa ai pati vërejtje në një pjesë të dokumentit ku kishte paqartësi në atë se ndonjë ministri mund të revokoj vendimet e Kuvendeve Komunale të Kosovës. Nënkryetari i komunës së Kaçanikut pyeti ministrin Haziri se si është menduar që përfaqësimi në njësit komunale pilot projekte të bëhet në formë partiake e qytetare. Pas diskutimeve të shumicës së pjesëmarrësve ministri Haziri iu përgjigj të gjitha çështjeve dhe dilemave të shtruara nga ana e përfaqësuesve të komunave dhe potencoi se do të jenë bashkë në gjithë procesin.



Kolegjiumi i Kryeshefat Ekzekutiv i shkruan letër kryeministrit z.Bajram Kosumi

Në Podujevë me 27 maj 2005 u mbajt takimi i radhës i Kryeshefave Ekzekutiv, ku në mes tjerash u diskutua problemi i shkurtimeve buxhetore në vitin 2005 dhe vështirësitë në menaxhimin financiar në vitin 2005.

Komunat për përpilimin e buxheteve të vitit 2005 kanë vepruar sipas Udhëzimeve të MEF-it (për çka edhe kishin vërejtje), por edhe për mbylljen e vitit buxhetor 2004 kanë vepruar sipas Udhëzimeve të MEF-it. Shkurtimeve buxhetore të vitit 2005 (në shkurt 2005) ndryshuan skemat buxhetore të aprovuara në dhjetor 2004 (për vitin buxhetor 2005), por këto shkurtime ndryshuan (në mënyrë të njëanshme) vetë politikat të cilat i kishte dhënë MEF për mbylljen e Vitit Buxhetor 2005.

Është një rast i pa presedan kur MEF merr (mos të themi "konfiskon") mjetet e zotuar, pjesa e mbetur - e pashpenzuar për shkak të ndërprerjes së punëve (nëntor, dhjetor, janar, shkurt, mars) për shkaqe atmosferike, e të njëjtat vazhdojnë me fillimin e sezonit ndërtimor. Dhe çka duhet bërë, të mbeten projektet e papërfunduara, apo të përfundojnë ato të filluara në vitin 2004 dhe të paguhen nga mjetet buxhetore të vitit 2005

dhe në vitin 2005 mos të ketë fare investime. Këto probleme të bartura nga vitit 2004 në vitin 2005 por edhe vet shkurtimeve e bëra për vitin 2005 do të bëjnë këtë vit një vit të vështirë buxhetor. Pritet që viti 2006 të jetë edhe më i vështirë se viti 2005, por për këtë vit kemi përgatitje, çka nuk ishte në vitin 2005 kur të gjitha ndodhën papritmas dhe Komunat do të kenë vështirë të bëjnë përshtatjet e nevojshme dhe menaxhim adekuat me gjendjen e krijuar. Ne i kuptojmë vështirësitë e Pushtetit Qendror por kjo është reciproke (me Pushtetin Lokal). Pasi është fillimi i Qershorit 2005, se pjesa e II-të e këtij viti do të merr formën e ndryshimit dhe përshtatjes së qëndruar por edhe fakti se PSSP ka bartur te Kryeministri autorizimet të cilat i kishte Këshilli Ekonomik Fiskal; po iu drejtohem me disa kërkesa konkrete:

1) Nuk janë bërë pagesat në emër të mëditjeve për anëtar të Kuvendit dhe të gjendet



mënyra e pagesës së tyre (alokim shtesë) por edhe lartësia e pagesës të jetë unike për të gjitha Komunat. 2) Mjetet e zotuar e të lidhura me Kontrata konkrete të vitit 2004, të rishqyrtohen edhe një here nga ana e MEF-it pasi Komunat kanë vepruar sipas Ligjit dhe Udhëzimeve të MEF-it për vitin 2005 (kurse të gjitha Komunat janë certifikuar për menaxhim, të pavarur financiar, çka nuk është rasti me agjencionet tjera Buxhetore).

3) Kemi propozuar dhe prapë kërkojmë nga Qeveria e Kosovës (MEF) që të zgjerohet baza e vjeljes së tarifave dhe ngarkesave për të hyrat e Komunave edhe me një të hyr nga shit - blerja e pasurisë së patundshme. Në të vërtetë kërkojmë që të na jipet pëlqimi për këtë tarifë dhe Ministria të bënë ndryshimet e nevojshme legislative.

4) Ne edhe më herët kemi kërkuar nga MSHP që Qendra për regjistrimin e automjeteve të vjelin tarifën me rastin e regjistrimit të automjeteve, të lejuara para tri viteve si tarifën të Komunave. Këto mjete Komunat do ti përdornin ekskluzivisht për rregullimin dhe meremetimin e rrugëve. Mirëpo, asgjë nga kjo. Tani Qendrat për regjistrimin e automjeteve vjelin taksa në regjistrim të automjeteve. Ne nuk kërkojmë të rritet lartësia

Nënshkrimet e Kryeshefave Ekzekutiv:

1. Mustafë Pllana - Mitrovicë
2. Mehmet Gashi - Podujevë
3. Imri Ahmeti - Lipjan
4. Ibrahim Kryeziu - Rahovec
5. Halil Tolaj- Deçan
6. Ejup Hashani - Obiliq
7. Shpend Trdevaj - Klinë
8. Gafurr Mustafa - Novobërdë
9. Agim Zenelaj - Suharekë
10. Islam Thaçi - Kamenicë
11. Halil Musliu - Viti
12. Naim Ismajli - Shtime
13. Enver Muja - Gjilan
14. Sahit Krasniqi - Ferizaj
15. Muharrem Parduzi - Vushtrri
16. Ragip Gajraku - Prizren
17. Ramiz Zeka - Pejë

e këtyre taksave (lartësia shtesë për Komuna) por 50 % e këtyre taksave ti takon Komunave dhe këto mjete të përdoren vetëm për rregullimin e rrugëve në Komuna.

5) Komunave të iu mundësohet sipas Ligjit mbi Pyjet 20% nga masa e eksploatuar drurorë si dhe të rregullohet shfrytëzimi i të hyrave nga dënimet mandatore.

6) Zotëri Kryeministër, Kryeshefat kërkojmë gjithashtu një takim me ju, edhe pse i dimë obligimet e mëdha të cilat ju i keni./

AKK-ja mori pjesë në takimin për pushtetin lokal në Antali të Turqisë

Në këtë takim është diskutuar për ndërtimin e kapaciteteve, menaxhimi financiar në qeverisjen lokale në E.JL, vetëqeverisjen lokale etj.

Organizuar nga "Institutit për Shoqëri të Hapur - OSI" e Hungarisë nga 1 deri më 5 qershor në Antali të Turqisë është organizuar takimi në lidhje me qeverisjen lokale.

Në këtë takim, ku AKK-në e ka prezantuar drejtori ekzekutiv i AKK-së z.Sazan Ibrahim, është diskutuar për ndërtimin e kapaciteteve, prezantimi i punës së NALAS-it (ku AKK-ka e ka statusin e përhershëm), pastaj është debatuar për punën e rrjeteve të institutëve publike të Evropës Qendrore dhe Jug-Lindore, menaxhimi financiar në qeverisjen lokale në E.JL, vetëqeverisjen lokale dhe demokratizmi etj./

Reformimi i pushtetit lokal i rëndësishëm për demokracinë dhe zhvillimin ekonomik në Kosovë



Reformimi i pushtetit lokal është një domosdoshmëri për proceset demokratike në Kosovë dhe mund të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, pa marr parasysh statusin e ardhshëm të Kosovës, ishte një nga konkludimet e konferencës dy-ditore, e cila përfundoi punimet dje në Prishtinë.

Kjo ngjarje mbledhi ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë me qëllim të shkëmbimit të ekspertizave të vendeve të rajonit të cilat kanë kaluar, ose po kalojnë nëpër të njëjtin proces. Konferenca po ashtu mori parasysh rezultatet pozitive të këtyre vendeve në lidhje me detyrën e ndërlikuar të reformimit të pushtetit lokal. "Në të ardhmen Kosova duhet dhe do të duhej të mbështetej shumë në përvojat rajonale të reformimit të pushtetit lokal, gjë që është shumë e rëndësishme në këtë kohë vendimtare," tha Ambasadori Werner Wnendt, Shef i Misionit të OSBE-së në Kosovë. Një përfundim tjetër nga konferenca ishte që, pasi kjo reformë është një proces afatgjatë dhe duhet të ndodhë në vazhdimësi, Institucionet e Përkohshme Vetë-Qeverisëse të Kosovës duhet të luajnë rol kyç në ofrim të udhëheqësisë për të mbajtur procesin brenda kornizave. Kjo nënkupton që Kuvendi i Kosovës miraton legjislacion të ri, ndërsa Ministrinë përmirësojnë rolin e tyre kundruall komunave. Në të njëjtën kohë, institucionet lokale duhet të forcohen për të ofruar shërbime më të mira dhe për të kontrolluar asetet komunale. Reformat legjislative do t'i ndihmonin qeveritë lokale që të shtojnë të ardhurat e tyre vjetore dhe të përmirësojnë procesin e planifikimit lokal që i kontribuon zhvillimit ekonomik, mbrojtjen më të mirë dhe përfshirjen e komuniteteve të vogla etnike dhe kthimin. "Reforma e pushtetit



lokal është faktor kyç për ofrimin efektiv të shërbimeve dhe zbatim të parimit evropian të vartësisë," tha Ambasadori Wnendt. "Në Evropë, niveli më i ulët i administratës është shumë i rëndësishëm, dhe kjo është e një



rëndësie të veçantë për të gjitha komunitetet në Kosovë." Përdërisa procesi i reformës është akoma në fazë fillestare, Kosova tashmë ka shembuj të punës së mirë në nivel lokal, si në Fushë Kosovë, Kamenicë,

Novobërdë, Shtërpcë dhe Prizren. Përfaqësues nga Gjakova, Shtimja dhe Skenderaj kanë folur për punën e komunave të tyre në promovimin e zhvillimit ekonomik lokal. Ambasadori i OSBE-së Wnendt po ashtu ka thënë se Misioni ka mirëpritur krijimin e pesë Grupeve Punuese, të cilat do të sigurojnë që procesi i reformimit të pushtetit lokal dhe decentralizimit përcillet, dhe se serbët e Kosovës dhe komunitetet tjera janë të përfshira në këtë proces. Në takimet e Konferencës kanë diskutuar edhe z.Lufti Haziri ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal, z.Ismet Beqiri ushtrues i detyrës së kryetarit të Asociacionit të Komunave të Kosovës etj. Konferenca u organizua nga OSBE-ja në bashkëpunim me MPL-në e AKK-në dhe UNDP-në.

Pjesë nga fjala e ushtruesit të detyrës së kryetarit të AKK-së z.Ismet Beqiri në Konferencën:

"Reforma e Qeverisjes Lokale në Kosovë-eksperiencia nga Evropa Juglindore"



Zonja dhe Zotërinj, Asociacioni i Komunave të Kosovës është themeluar në Kuvendin themelues me 30 qershor 2001, pas zgjedhjeve të para demokratike komunale në Kosovën e pasluftës. Kuvendi i Dytë është mbajtur më 29 shtator 2003 pas zgjedhjeve të dyta lokale në Kosovë. Duke u nisur nga objektivat e AKK-së mund të shihet qartë se AKK-ja angazhohet që në Kosovë të implementohen rregullat nga Karta Evropiane për qeverisjen lokale, të organizoj dhe koordinoj aktivitetet e anëtarëve të saj në sferën e investimeve, në zhvillimin ekonomik të komunave, në përmirësimin e bazës ligjore, të përkrahjes së komunitetit të biznesit, në preventivë dhe kundër krimit, në kulturë,

arsim, shkencë, mbrojtje shëndetësore, në çështje sociale dhe përkrahjes sociale, në zgjidhjen e konflikteve, në përmirësimin e shërbimeve për qytetarët dhe në raportet me Asociacionet simotra jashtë shtetit dhe me organizatat ndërkombëtare. Kjo konferencë po mbahet gjatë periudhës kohore kur reformimi i qeverisjes lokale në Kosovë është në fazën fillestare të saj. Pritet që të përkrahjet rrjeti në mes komunave të regjionit dhe shkëmbimi i përvojave të mira. Konferenca organizohet nga OSBE Misioni në Kosovë, në bashkëpunim me Asociacionin e Komunave të Kosovës, Ministrinë për Administratën e Pushtetit Lokal të Kosovës dhe UNDP. Progresi i arritur në Kosovë në vitet e pasluftës dhe afrimi aq afër formalizimit të zhgjidhjes së statusit të Kosovës është edhe progresi i të arriturave të pushtetit lokal në Kosovë e në këtë rast edhe i Asociacionit të Komunave të Kosovës si organizim në nivelin kombëtar të Kuvendeve Komunale të Kosovës. Andaj synimi ynë ka qenë mbështetja dhe promovimi i punës së pushtetit lokal dhe në imazhin

që gëzon sot, tregon se ato synime përafërsisht janë arritur. Mirëpo ne me këto arritje nuk duhet të që të ndalim punën tonë sepse gjithmonë kemi synuar dhe synojmë të arrijmë edhe më shumë se çka kemi arritur. Rruga e nisur e udhëheqjeve komunale të legjitimuar me votën e qytetarëve duhet vazhduar edhe më tej. Kjo rrugë përfshin që nga ofrimi i shërbimeve të përditshme për qytetarët, krijimin e infrastrukturës për një jetë sa më të lehtë e deri tek ngritja dhe forcimi i institucioneve komunale deri aty ku të gjithëve do t'u hiqen dyshimet për stabilitet të qëndrueshëm komunal. Pushteti lokal në Kosovë pas disa viteve do të duhej të ishte në mision të njëjtit, në këtë shërbim ndaj qytetarëve por në suaza të përmirësimeve të vazhdueshme. Pushteti lokal në vitet që vijmë do të reformohet krahas zhvillimeve politike e ekonomike me synimet tona nacionale për të cilin kemi krijuar bazamentin dhe kemi plotësuar shumicën e parakushteve.

**Ju faleminderit
Ismet Beqiri**

Konferenca ndërkombëtare për rolin e autoriteteve lokale dhe rajonale në konsolidimin demokratik të vendeve të Ballkanit Perëndimor

Kjo konferencë është organizuar nga Komiteti i Rajoneve në bashkëpunim me Komisionin Evropian, Këshillin e Evropës dhe Paktin e Stabilitetit.

Pa përkrahjen financiare dhe politike të Bashkimit Evropian Kosova do të ketë vështirë të ecë përpara, kurse moszgjdhja e statusit është pengesë kryesore për zhvillimin ekonomik të vendit, ka vlerësuar kryeministri Bajram Kosumi në hapje të konferencës ndërkombëtare për rolin e autoriteteve lokale dhe rajonale në konsolidimin demokratik në vendet e Ballkanit Perëndimor, që është mbajtur të mërkurën në

Prishtinë. "Statusi përfundimtar është përcaktues i shumë zhvillimeve në të ardhmen dhe mos zgjatja e tij është vërë pengesë e raporteve të mira të Kosovës dhe vendeve fqinje", tha kryeministri Bajram Kosumi. Reforma e pushtetit lokal, sipas kryeministrit, është një segment i rëndësishëm i demokracisë. Ai po ashtu përsëriti qëndrimin se pakicat etnike në shtetin e Kosovës nuk do të jenë të izoluar.

"Duam që qyteti ynë të jetë sa më afër qendrës ku merren vendimet, që të ketë mundësi të ndikojë sa më shumë në vendimmarrje në çështjet që kanë të bëjnë me jetën e tij të përditshme. Së dyti, duam të dërgojmë mesazhin se në shtetin tonë të ardhshëm minoritetet nuk do të jenë grupe të vogla etnike të marginalizuara, por të respektuara", ka thënë Kosumi.

Ndërkaq, përfaqësuesit ndërkombëtarë thanë se decentralizimi është njëri nga kushtet kryesore për integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në Evropë. Fabrizio Barbaso, drejtor i përgjithshëm i Drejtoratit për Zgjerim në Komisionin evropian, tha se ndihma nuk do të mungojë, mirëpo ajo nuk do të jetë falas. "Siç treguan referendimet për Kushtetutën Evropiane, qytetarët tanë nuk pajtohen që t'u hapin derën vendeve të cilat nuk janë të gatshme për të zbatuar vlerat evropiane dhe për të përmbushur kushtet tona" ka thënë Barbaso. Përfaqësuesi i Komitetit i Rajoneve Albert Bore ka thënë se reforma e pushtetit lokal është një proces i rëndësishëm dhe nuk mund të realizohet thjesht duke futur para në këtë proces, por kjo reformë, duhet të fillojë nga vetë njerëzit duke mos qenë e imponuar, apo ndonjë përsëritje e modeleve të ngjashme të vendeve të tjera.

Oven Masters, përfaqësues nga Këshilli i Evropës duke folur për rëndësinë e reformave të pushtetit lokal në vendet e Ballkanit Perëndimor ka përmendur përvojën në lidhje me decentralizimin në Maqedoni. Sipas shefit të Shtyllës së Katërt të



**Fabrizio Barbaso -
Drejtor i përgjithshëm
i Drejtoratit për
Zgjerim në Komisionin
Evropian**

Fjala e Asociacionit të Komunave të Kosovës në këtë Konferencë

Duke folur në këtë Konferencë z. Ismet Beqiri u.d. i kryetarit të AKK-së, pasi paraqiti të dhëna lidhur me themelimin dhe punën e AKK-së shtoi se "progresi i arritur në Kosovë në vitet e pasluftës dhe afrimi aq afër formalizimit të zgjidhjes së statusit të Kosovës është edhe progresi i të arriturave të pushtetit lokal në Kosovë e në këtë rast edhe i Asociacionit të Komunave të Kosovës si organizim në nivelin kombëtar të Kushtetutës Komonale të Kosovës. Pushteti lokal në Kosovë pas disa viteve do të duhej të ishte në mision të njëjtë, në këtë shërbim ndaj qytetarëve por në suaza të përmirësimeve të vazhdueshme. Pushteti lokal në vitet që vijnë do të reformohet krahas zhvillimeve politike e ekonomike me synimet tona nacionale për të cilin kemi krijuar bazamentin dhe kemi plotësuar shumicën e parakushteve. Reforma në pushtetin lokal është një domosdoshmëri e kohës, në mënyrë që qeveria komunale të jetë në gjendje të punojë në mënyrë më funksionale dhe efektive, dhe në anën tjetër qytetari të jetë më afër procesit të vendimmarrjes, dhe të përfitojë nga shërbimet e dedikuara për të. Besojmë se AKK do të jetë shumë proaktive që të drejtat e qytetarit të jetësohen në mënyrën më të mirë të mundshme, dhe për afatin sa më të shkurtë kohor. Në këtë aspekt shpresojmë se edhe kjo konferencë, por edhe aktivitetet tjera do të kontribuojnë që të përforcojmë rolin e komunave në bërjen e ndryshimeve, dhe që të shkëmbejmë përvojat e vlefshme edhe me rajonin dhe më gjerë, në mënyrë që të sigurojmë zhvillime të qëndrueshme dhe mirëqenie për çdo qytetar të Kosovës".



Asociacioni i Komunave të Kosovës
Association of Kosovo Municipalities
Asociacija Kosovskih Opština

UNMIK-ut, Joakim Ryker, Kosova ndodhet në një periudhë sfiduese kur pritet hapja e diskutimeve për statusin. Decentralizimi, siç tha ai, është faktor vendimtar në këtë proces. "E ardhmja e çdo vendi të Ballkanit Perëndimor është integrimi. Asnjëri nga vendet nuk mund të qëndrojë i vetmuar dhe vetëm integrimi politik dhe ekonomik mund t'i bëjë këto vende të qëndrueshme", ka thënë Ryker.

Qeveria e Kosovës së shpejti pritet të fillojë 5 pilot projektet si fazë përgatitore për reformën e pushtetit lokal. Ministri i Pushtetit Lokal Lutfi Haziri tha se procesi do të përcillet me hartimin e pakos së ligjeve përkatëse, regjistrimin e popullsisë dhe zgjerimin e çështjeve ekonomike nëpër komuna. "Kërmë një monitorimi 15-18 muor ne do të kemi rezultate që do të tregojnë qartë se si do të organizohet pushteti lokal. Angazhimi ynë është që të vendosen dy nivele administrative të pushtetit lokal dhe të rregullohen raportet legale e administrative. Së shpejti kjo ministri nuk do të ketë punë sepse qeveria lokale do të bartet tek të zgjedhurit lokal", ka thënë Haziri./

Vazhdon dialogu ndëretnik mes komuniteteve

Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe CARE Int.kanë vazhduar takimet me përfaqësues të fshatrave në kuadër të Dialogut ndëretnik. Kështu, me 27 qershor është organizuar një takim me përfaqësuesit serb të fshatrave të Regjionit të Pejës, Prishtinës dhe Mitrovicës.

“Fatkeqësisht, rajoni ynë Ballkani ende mund të quhet si një rajon jo i stabilizuar ekonomikisht dhe politikisht. Por të gjithë ne së bashku me Institucionet e Kosovës dhe ato ndërkombëtare jemi duke punuar që të kemi një Kosovë stabile pa marrë parasysh së nga cili aspekt shikohet” – tha në hapje të takimit z.Sazan Ibrahimij drejtor ekzekutiv në AKK. Ai vazhdoi se “Kosova duhet të jetë një model i bazuar në tolerancën ndëretnike dhe në të cilin vend ka hapësirë për çdo njeri pavarësisht se nga cili komunitet vie. Një model bazuar në standardet e larta për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe në pjesëmarrjen aktive të këtyre komuniteteve në Strukturat Qeverisëse në Kosovë. Rrjedhimisht, Kosova është një faktor stabiliteti në rajon dhe si e tillë, është një partner për komunitetin ndërkombëtar. Mund të them se kemi përkrahje të fuqishme nga përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar me qenë se Kosova bashkohet dhe angazhohet për përmbushjen e vlerave universale të kohëve të sotme: demokracia, të drejtat e njeriut, mosdiskriminim, toleranca dhe sundimi i ligjit. Ne mund të kemi probleme, por ne duhet t'i zgjidhim këto probleme nëpërmes Institucioneve të Kosovës si dhe me bashkëpunimin e ngushtë të këtyre institucion-



eve dhe Bashkësisë Ndërkombëtare. Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) së bashku me Komunitet e Kosovës dhe Institucionet e Kosovës do të mundohet të eliminojë të gjitha arsyet për tensione ndëretnike, pa dëmtuar procesin e integritetit të të gjithë qytetarëve në shoqërinë e Kosovës. Qëllimi ynë është ndërtimi i një Kosove demokratike. Duke marrë parasysh se fshati është njëri ndër vendet më të afërta të qytetarit, AKK-ja beson se disa probleme mund të zgjidhen duke filluar po nga ky nivel. Kjo është e domosdoshme dhe ne si AKK do të mundohemi që përmes mekanizmave institucionale të fillojmë të mendojmë për zgjidhjen e disa problemeve që e preokupojnë qytetarin e Kosovës”. Duke marrë pjesë në debat kryetari i komunës së Lipjanit z.Xhevat Olluri tha se “në komunën e Lipjanit nuk ka eksese që e bëjnë jetën e qytetarëve të pasigurt. Në lidhje me pronat e uzurpuara kemi çka të bisedojmë dhe ne si komunë jemi në kontakt me Gjykatën që pronarëve legjitim derisa nuk kemi hasur në bashkëpunim

me UNHABITAT-in në këtë segment”. Nënkryetari i komunës së Klinës z.Prenk Gjetaj në fjalën e vet tha se “Ecjen e shpejtë në komunën tonë e pengon mos gjetja e qytetarëve të zhdukur si dhe pasojat materiale të luftës dhe zhagjitja në rindërtimin e shtëpive të dëmtuara gjatë luftës. Para dy viteve në komunën e Klinës është bërë hapi i parë në rindërtimin e shtëpive për të kthyerit, mirëpo të gjithë qytetarët duhet të tregojnë gatishmëri për të pranuar realitetin e ri dhe shërbimet komunale”. Përfaqësuesi i CARE Int. z.Alban Ibrahimij tha se “ky takim ofron mundësi për dialog mes përfaqësuesve të fshatrave dhe krerëve komunale për të tejkaluar pengesat e mundshme”. Drejtori i Administratës së Përgjithshme në Komunën e Mitrovicës z.Isa Hyseni tha se “ne si qytet i ndarë jemi për dialog ndëretnik dhe për këtë arsye kemi formuar këshillin Multietnik, ndërsa për çështje të mëdha pozitive duhet vullneti i të dy palëve derisa dihet se Kuvendi Komunal i Mitrovicës është për demokraci të mirëfilltë dhe barazi për të gjithë në kuadër të normave evropiane”. Z.Ivica Milic përfaqësues i një fshati në komunën e Lipjanit tha se “sa i përket lirisë së lëvizjes ajo ka ecur shumë përpara dhe vërehet një angazhim i madh i udhëheqjes komunale në këtë drejtim. Ndërsa edhe ne si komunitet kemi probleme të njëjta sikur edhe komunitetet tjera. Lipjani është komunë multietnike mirëpo ka problem me transport si brenda komunës ashtu edhe me komunat fqinje”. Pasi diskutimeve të shumicës së pjesëmarrësve të takimit, dolën me këto **konkluzione**.

1. Dialogu Ndëretnik me lider të fshatrave mund të jetë një faktor i rëndësishëm në stabilizimin e situatës në Kosovë dhe shtyerjen e proceseve përpara.

2. Situata në Kosovë është përmirësuar dukshëm në raport me vitet e kaluara por me këtë nuk duhet të kënaqemi. Edhe më tej duhet të punojmë në përmirësimin e situatës siç është liria e lëvizjes, kthimi, integrimi i komuniteteve në jetën shoqërore politike të Kosovës

3. Iniciativat nga Komunitetet minoritare në Kosovë janë të mirëseardhura dhe më se të domosdoshme në përmirësimin e jetës së tyre në Kosovë.

4. Debatete me qytetarë të inicluara nga Komunitet dhe komunitetet e ndryshme për problemet e qytetarëve luajnë një rol të rëndësishëm në zbutjen e vështirësive të komuniteteve

5. Mediat elektronike dhe ato të shkruara duhet të japin apo plasojnë më shumë informata për ngjarjet pozitive që ndodhin në Kosovë e jo vetëm ato negative.

6. Përmirësimi i situatës ekonomike në Kosovë është një ndër faktorët kyç në procesin e kthimit dhe integritetit të komuniteteve të ndryshme joshqiptare në proceset vendimarrëse.

7. Duhet të ketë më shumë:

a) takime të tilla pra takime në të cilat komunitet mund të diskutojnë për problemet e ndryshme

b) aktivitetet kulturore-rinore-sportive në mes komuniteteve të ndryshme

8. Transporti publik duhet të rregullohet për minoritete

9. Standardet janë për të gjitha komunitetet e jo vetëm për shqiptarët, pra të gjithë duhet të punojnë së bashku në implementimin e standardeve

10. Popullata shumicë duhet të marrë përsipër mbrojtjen e pakicave

11. Sinqeriteti ndaj njëri-tjetrit ndikon në rritjen e e krijimit të besimit të ndërsjellë

12. Kontakte më të shpeshta të qytetarëve nga rrada e pakicave me aturitete lokale dhe qëndrore ngrit nivelin e besueshmërisë dhe informimit për aktivitetet e ndërsjellta

13. E drejta pronësore juridike duhet të zgjidhet sa më shpejtë në mënyrë që pronarët e vërtetë të kthehen në vendbanimet e mëherëshme

14. Duhet të ekzistojë vullneti i dyanshëm për zgjidhjen e problemeve.

AKK dhe MMPH organizuan takimin “Qyteti i qëndrueshëm 2005 – Riciklimi dhe Kompostimi i Mbeturinave”

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës kanë organizuar Uorkshopin me temën “Qyteti i qëndrueshëm 2005 – Riciklimi dhe Kompostimi i Mbeturinave” i cili u mbajt në Vila Gërmia – Prishtinë më 26 Maj, 2005. Në këtë takim pune morën pjesë përfaqësuesit e qeverisë qendrore, Kuvendeve Komunale, Institucioneve Shëndetësore dhe Mjedisore, donatorët ndërkombëtar, OJQ-të lokale dhe ndërkombëtare. Në këtë takim folën edhe z. Pierpaolo Gintoli – COOPI – Cooperazione Internazionale, z.Agim Zajmi nga Ministria e Bujqësisë, në temën “Roli i Asociacionit të Komunave në projektet mjedisore regjionale” foli z.Ismet Beqiri u.d. i kryetarit të Asociacionit të Komunave të Kosovës.

U prezantua Draft-Plani Strategjik për koordinatorët komunal për të Drejtat e Fëmijëve

Asociacioni i Komunave të Kosovës së bashku me Forumin për të Drejtat e Fëmijëve kanë prezantuar Draft-Planin Strategjik për koordinatorët komunal për të Drejtat e Fëmijëve.

Ky draft plan ka ardhur si rezultat i seminarit trajnues i cili është mbajtur në Strugë në muajin prill në të cilin janë trajnuar të gjithë koordinatoret komunalë për të drejtat e fëmijëve lidhur me hartimin e draft planit strategjik për koordinatorët komunal për të drejtat e fëmijëve.

Që nga ajo kohë e deri në prezantimin e këtij draft plani, puna e koordinatoreve komunalë si dhe akterëve të tjerë të përfshirë në hartimin e këtij draft-planit ka qenë e përqendruar në punën në grupe të cilët kanë punuar në mënyrë intensive lidhur me finalizimin e këtij draft plani strategjik për koordinatorët komunal për të drejtat e fëmijëve. Roli i AKK-së në hartimin e këtij draft-ani ka qenë mjaft i madhe duke marrë pjesë direkt në të gjitha takimet e grupeve punuese lidhur me hartimin e këtij draft plani.

Duke marrë pjesë në takimin e prezantimit të draft planit strategjik për koordinatorët komunalë për të drejtat e fëmijëve, ministri i Ministrisë së Pushtetit Lokal z.Lutfi Haziri tha se "e përshëndesim iniciativën dhe ne si Ministri e Pushtetit Lokal do të vazhdojmë të përkrahim koordinatoret komunalë së bashku me

Asociacionin e Komunave të Kosovës. Njëkohësisht kërkojmë nga ju që të vazhdoni këtë punë dhe këtë aktivitet deri sa të krijohen mundësi reale që ne të mund të ndihmojmë drejtpërdrejtë në sqarimin e pozitës zyrtarëve në këtë drejtim"

"Asociacioni i Komunave të Kosovës si përfaqësues i interesave të pushtetit lokal ka përkrahur iniciativën për emërimin e koordinatoreve komunal për të drejtat e fëmijëve tha në fillim të fjalës së tij z.Sazan Ibrahim i drejtor ekzekutiv në AKK. Ai shtoi se "në kuadër të kësaj iniciative janë mbajtur disa takime të ndryshme në bashkëpunim me Forumin për të Drejtat e Fëmijëve. Sa i përket hartimit të këtij draft plani strategjik mund të thuhet se është bërë një punë e mirë në këtë drejtim, sepse mendojmë se është krijuar një bazë e mirë vet vet punën e koordinatoreve por edhe për komunat të cilat do ta kenë më lehtë për t'iu qasur kësaj fushe dhe për t'i adresuar drejtë çështjet e ndryshme që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve. Duke marrë parasysh se një ndër objektivat e AKK-së është forcimi i rolit të komunave dhe pushtetit lokal, AKK-ja edhe në të ardhmen do të llojë në interes të komunave, në mënyrë që nga kjo të përfitojnë të gjithë qytetarët dhe veçanërisht fëmijët që përbejnë një përqindje të madhe të shoqërisë në përgjithësi ne



Kosovë". Përfaqësuesi i UNICEF-it z. Robert Fredrich tha se "Kjo strategji është një përgjigje konkrete për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve. Strategjia e cila po diskutohet këtu, lidhur me planin për të krijuar një jetë më të mirë për fëmijët ka një rëndësi të madhe që të fillohet të implementohet nëpër të gjitha komunat. Znj.Arben Kuriu përfaqësues e Forumit për të Drejtat e Fëmijëve tha se "prej emërimit të koordinatoreve komunal për të drejtat e fëmijëve është punuar në fuqizimin e pozitës së tyre në komunë pasi që një nga sfidat e punës së tyre ka qenë statusi i pa definuar i tyre". Znj.Kuriu po ashtu paraqiti në hollësi gjithë procesin që ka sjell deri të hartimit i Draft Planit Strategjik. Koordinatorja komunale e komunës së Ferizajit znj. Fatbardha Zogaj në emër të koordinatoreve komunalë për të drejtat e fëmijëve paraqiti në detaje gjithë Planin Strategjik duke bërë edhe

rezyme për secilin segment.

Drejtori i Zyrës për qeverisje të mirë dhe të drejtat e fëmijëve pranë zyrës së kryeministrit z. Abit Hajredini theksoi nevojën që koordinatoret komunalë të institucionalizohen dhe tha se "ne si zyrë përkrahim këtë iniciativë mjaftë të qëlluar në hartimin e këtij plani strategjik". Përfaqësuesja e MASHT-it znj. Miranda Kasneci tha se "MASHTI e mirëpret këtë iniciativë të qëlluar dhe me kohë do të jap vërtetet dhe sugjerimet me shkrim pranë organizatave që kanë punuar në këtë draft të planit strategjik për të drejtat e fëmijëve. Përfaqësuesi i MPMS-së z.Muhamet Gjocaj premtoi përkrahje dhe tha se "MPMS është e përgatitur për të bartur kompetencat nga qendrat për punë sociale nëpër komuna". Kryeshefi i komunës së Ferizajit z.Sahit Krasniqi pasi përshëndeti këtë takim tha se nga prezantimi i draft planit strategjik shihet se një barrë e madhe në këtë drejtim pritet të bie mbi kryeshefat ekzekutiv dhe ne e mirëpresim punën e koordinatoreve komunalë për të drejtat e fëmijëve. Pas diskutimeve në fund doli ideja e mbajtjes edhe të një takimi tjetër me të gjithë akterët e përfshirë në hartimin e këtij draft plani strategjik në mënyrë që të behët rishikimi i tij dhe të përfshihen vërejtjet, rekomandimet dhe sugjerimet e dala nga ky takim ndërsa më pas ky draft plan strategjik për koordinatoret komunal t'i dorëzohet kryeshefave ekzekutiv për miratim. /



“Streetball Kosova” e AKK-ja organizuan turnet e basketbollit me shtrirje në 7 qendra të Kosovës



Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe Firma për Veprimtari Sportive “Street Ball Kosova” përmes një marrë-veshje mirëkuptimi kanë bashkërunder aktivitetet në organizimin e turneut tashmë tradicional, që këtë vit u quajt “Dukagjini Streetball Kosova 2005”. Ky projekt është implementuar në komunat: Prishtinë, Prizren, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë dhe Ferizaj. Sipas planit të paraparë turnet janë organizuar kryesisht në kohën e përcaktuar e që ndihmë të madhe kanë dhënë Drejtoritë Komunale për Sport të këtyre komunave. Kurse fituesit e turneve nëpër komuna ka marrë pjesë në finalen e cila u mbajt në Prishtinë. /

AKK-ja dhe SHKNRR organizuan seminarin për ndërtimin e rrugëve

Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe Shoqata Kosovare për Ndërtimin e Rrugëve organizuan seminarin për të sjellë bashkë investitorët në ndërtimin e rrugëve dhe kompanitë që në mënyrë tipike bëjnë ndërtimin. Ky seminar ishte planifikuar në konsultim me projektin e KCBS-së me qëllim të zhvillimit të kllasterit të materialeve ndërtimore. Seminari do të siguroj një mundësi që komunat në mënyrë që të garantojnë që buxheti i tyre i kufizuar është shpenzuar me kursime. Ndër të tjera në seminar u diskutuan këto tema: Rëndësia e standardeve në përgjithësi dhe veçanërisht në ndërtimin e rrugëve, Procesi i sigurimit dhe rëndësia e kushteve specifike, Rëndësia e kontrollit, Obligimi i investitorëve për të kon-



trolluar dhe miratuar/refuzuar, Bashkërendimi me veglat e tjera publike për përmirësime të menjëhershme, Shembujt e fundit të ndërtimit të rrugëve etj. Në hapje folën z. Ismet Beqiri u.d. i kryetarit të AKK-së, z. Muhamet Dervishi kryetar i Bordit të SHKNR dhe z. Martin Wood nga projekti i programit të USAID-it, KCBS./

<h3>Adresa e Re</h3> <h2>Asociacioni i Komunave të Kosovës</h2> <p>Rr. “Rexhep Mala” nr.12 Prishtinë Tel. 038 245 734 Fax. 038 245 733</p> <p>(rruga e parë në të majtë nga Menza e Studentëve)</p>	<p>RIINVEST</p>	<p>Menza e Studentëve</p>
	<p>Rruga “Rexhep Mala”</p>	
	<p>AKK</p>	<p>Ombudspersoni</p>
	<p>Instituti Albanologjik</p>	

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

BULETINI

Viti II, Nr. 10 - Maj & Qershor 2005

Bordi Botues: Sazan Ibrahim, Arsim Osmani, Mexhit Shaqiri, Merita Krasniqi

Tel&Fax: 038 / 245 - 734
www.komunat-ks.net info@komunat-ks.net

Asociacioni i Komunave të Kosovës mbështetet nga Agjensioni Evropian për Rindërtim përmes projektit “Përkrahje decentralizimit në nivelin komunal”, implementuar nga IFES Ltd.



Statusin e Vëzhguesit



Asociacioni i Komunave të Kosovës
Association of Kosovo Municipalities
Asociacija Kosovskih Opština



Anëtar i përhershëm